Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1062
Data e Vendimit: 04.01.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE " AMBIENTI " SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT" me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën 04/01/2024, mori këtë:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e " AMBIENTI " SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/1062, e datës 29/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal – Rahovec.

2.I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal – Rahovec që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 29.12.2023 ka pranuar ankesën me nr.1062/23 nga " AMBIENTI " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 29.11.2023 Kuvendi Komunal – Rahovec ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e lartcekur. Sipas këtij njoftimi afati i fundit për pranimin e tenderëve është 14.12.2023. Ndërsa me datën 20.12.2023 ka publikuar B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, sipas këtij formulari afati i fundit për pranimin e tenderëve është 29.12.2023.

Me datë 22.12.2023 (e premte) ora 20:36 OE "AMBIENTI" SH.P.K. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së ndërsa me datë 26.12.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të jashtafatshme.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 29.11.2023, ndërsa me datën 20.12.2023 AK ka publikuar B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, sipas këtij formulari afati i fundit për pranimin e tenderëve është 29.12.2023. OE " AMBIENTI " SH.P.K. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 22.12.2023 (e premte) ora 20:36 dhe konsiderohet se është pranuar nga ana e Autoriteti Kontraktues me datën 26.12.2023 (pra në ditën e parë vijuese të punës) e cila edhe është refuzuar si e jashtafatshme.

Zyra për pranimin e ankesave, pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues e ka paraqitur jashtë afateve ligjore si dhe nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave*.

Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit*

se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).

Si dhe neni 5 i LPP-së përcakton se*: Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.*

Duke u bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së të datës 07.11.2023 dhe dispozitave të lartcekura OSHP thekson se sipas Njoftimit për kontratë afati i fundit për pranim të tenderëve ishte data 29.12.2023, andaj OE ankues " AMBIENTI " SH.P.K., ka qenë i obliguar të paraqes kërkesë për rishqyrtim brenda afateve ligjore.

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 29.12.2023nga OE " AMBIENTI " SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me titull:"PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe 111 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal - Rahovec që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- OE - **" AMBIENTI " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: